

**VENDIM**  
**Nr. 26, datë 9.2.2023**

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME  
APLIKIMIN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SHPK PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 134/5 prot., datë 7.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘Sunpower 2017’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 2, datë 10.1.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.1.2023 dhe 12.1.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 20.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 134 prot., datë 16.1.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 134/1 prot., datë 27.1.2023, dhe nr. 134/3 prot., datë 2.2.2023.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga ana e shoqërisë vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**